



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

KOSOVO CENTER FOR PUBLIC SAFETY EDUCATION AND DEVELOPMENT
QENDRA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE EDUKIM DHE ZHVILLIM
KOSOVSKI CENTAR ZA JAVNU BEZBEDNOST OBRAZOVANJE I RAZVOJ

Duke u bazuar në rregulloren 2001/36, Urdhëresën administrative 2003/2 dhe Udhëzimin Administrativ 2003/1, Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim në Vushtri, zyra Personelit shpallë:

K O N K U R S

Titulli i Vendit të punës: **Shef i Sektorit të Sigurimit**

Departamenti: **Administratë dhe Logjistikë**

Koeficienti: **(8) Sipas Rregullores 2001/36 mbi Shërbimin Civil**

Raporton: **Udhëheqësi i Administratës dhe Logjistikës**

Nr.Ref: **09/2010**

Vendi: **Vushtri**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheqësve të ndërrimit, cakton detyrat individuale për rojet sipas nevojës në mungesë të Udhëheqësit të Operativës së Sigurimit. Siguron që Udhëheqësit e Ndërrimit dhe Rojet janë në rrjedhë të PSO-ve dhe parimeve. Të jetë në dijeni për restriksionet e udhëtimit dhe për kushtet alarmuese duke u konsultuar me Drejtoratin e Qendrës.
- Mban kontrollin efektiv të personelit të sigurimit, udhëheqë/planifikon pushimet, pushimet kompensuese, punët jashtë orarit dhe mbulimin e ndërrimeve. Formon raporte koncize në lidhje me informatat statistikore për nevojat planifikuese dhe operationale te sektorit. Asiston në selektimin e stafit lokal duke zbatuar udhëzuesit QKSPEZH-it për punësim.
- Udhëheqë inspektimet e paparalajmëruara të Udhëheqësve të Ndërrimit dhe të personelit të sigurimit për të siguruar mbikëqyrje të duhur. Kryen vlerësimet e punës dhe zhvillon strategji të re kur nevojitet shtimi i personelit të sigurimit.

- Merr rolin udhëheqës në planifikimin dhe organizimin e sigurimit për ceremonitë e diplomimit të studentëve të cilat mbahen jashtë kompleksit shkollor. Mbanë lidhje të duhur me Logjistikën,QKSPEZH-it dhe OSBE-në, bien vendime dhe i pason të gjitha çështjet të cilat duhet t'i adresohen Drejtoratit të QKSPEZH-it.
 - Pas punëve në zyre,vepron si pikë kontaktuese për udhëheqësit e ndërrimit të sigurimit,reason në incidentet e pazakonshme.I përdorë aftësitë gjuhësore për t'i ndihmuar personelit të sigurimit kur kanë të bëjnë me personelin ndërkombëtarë dhe vizitorët brenda kompleksit të QKSPEZH-it.
 - Vepron si anëtarë të Ekipit për reagim emergjent në rastet emergjente, p.sh. zjarr,fatkeqësi natyrore dhe të rreziqeve tjera për studentët,personelin,duke marrë vendime të menjëhershme në lidhje sigurinë e personelit të SHPK-së dhe të studentëve.
- Merr pjesë në mbledhjet kur është e nevojshme dhe kryen obligime të tjera sipas kërkesave apo urdhrave të Drejtorit të QKSPEZH-it, Zv. Drejtorit të QKSPEZH-it.

Shkathtësitë kyçe,njohuria,aftësitë e nevojshme:

- Aftësi për të kaluar periudha të jashtë për inspektim,shoqërim të patrullave,qëndrim në pikat e caktuara për trajnim dhe vlerësim të personelit të sigurimit.
- Kërkohejt që të kalohet një kohë e konsiderueshme në kushte jo të përshtatshme atmosferike.
- Aftësi organizimi dhe delegimi të punës.
- Aftësi organizimi të trajnimeve të ndryshme me sigurinë për personelin e sigurimit.
- Aftësi për të punuar jashtë orarit të punës kur ka nevojë për këtë.
- Aftësi për shkruarje të raporteve koncize duke përdorur shkathtësi kompjuterike.

Kualifikimet edukative dhe profesionale për post:

- Përgatitje Universitare,Lëmin e shkencave shoqërore.
- 2 Vite përvojë pune (në fushën e Sigurisë të ngjashme,trajnime në fushën e sigurisë).
- Njohja e gjuhës Shqipe ose Serbe (në të folur dhe të shkruar).
- Njohja e gjuhës Angleze (në të folur dhe të shkruar) e dëshirueshme.
- Shkathëtit me kompjuter duke përfshirë Microsoft Word, Excel dhe Power Point-esenciale.
- Fleksibiliteti dhe aftësia për të punuar nën presion dhe Brenda kohës së caktuar,janë të nevojshme.